



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "ASSET ING" të datës 27.04.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet - Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-40-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET PJESËRISHT** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "ASSET ING" të datës 27.04.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet - Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-40-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "ASSET ING" (tutje "parashtruesi") me datë 27.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet - Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-40-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Autoriteti Kontraktues kishte shpallur aktivitetin e prokurimit “**Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet**” me nr. të prokurimit: **616-25-6217-5-2-1**, me datë 17.07.2025. Me vendimin e datës 22.10.2025 kemi pas pranuar letrën standarde për eliminim, dhe më datë 12.11.2025 kemi parashtruar ankesë me nr. **2025/1118**, lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit. Një ndër arsyet e eliminimit të ofertës sonë në atë procedurë ishte:

Nuk është dëshmuar leja/pëlqimi mjedisor për grumbullimin, ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënojave, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ose nga Komuna. Leja e paraqitur nuk është e destinuar për azbest sipas kërkesës dhe Aneksit 1 të detyrueshëm.

Në kuadër të ekspertizës nr. **2025/1118**, është konstatuar si vijon:

- Kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë që OE të posedojë pëlqim mjedisor për grumbullimin, ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënojave, **pa specifikuar azbestin;**
- GOE ka dorëzuar:

- leje komunale për deponim të përkohshëm dhe trajtim të mbeturinave ndërtimore;
- si dhe leje shtesë për mbetje të rrezikshme;
- Eksperti shqyrtues ka vlerësuar se këto dokumente e përmbushin kërkesën e DT-së;
- Është theksuar qartë se, edhe pse aktiviteti lidhet me materiale të rrezikshme si azbesti, **kërkesa e DT-së nuk e përmend specifikisht azbestin**, dhe për këtë arsye nuk mund të kërkohej një leje e tillë si kusht eliminues.

Si rrjedhojë, pretendimi i GOE është gjetur i bazuar, dhe kjo ekspertizë është miratuar nga Paneli i OSHP-së, duke krijuar një interpretim të qartë dhe detyrues për këtë kriter.

Autoriteti Kontraktues, respektivisht Komuna e Prishtinës, ka rishpallur aktivitetin më datë 13.01.2026, duke e lënë kërkesën identike, pa asnjë ndryshim në formulim.

Më datë 22.04.2026 kemi pranuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku përsëri një ndër arsyet e eliminimit është se leja mjedisore e paraqitur nuk është e destinuar për azbest, duke u referuar kërkesave të DT-së dhe Aneksit 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme.

Kërkesa në Dosjen e Tenderit (DT), si në procedurën e parë ashtu edhe në ri-tenderim, ka qenë identike, konkretisht:

- **Kërkesa:** Operatori ekonomik duhet të ketë pëlqim mjedisor për grumbullimin, ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënojave, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ose nga Komuna;
- **Dëshmia:** Kopje e pëlqimit mjedisor për këto aktivitete.

Në asnjë rast në këtë kërkesë nuk është specifikuar që pëlqimi mjedisor duhet të jetë i dedikuar në mënyrë eksplicite për azbest.

Në ri-tenderimin e këtij aktiviteti

- Kërkesa në Dosjen e Tenderit ka mbetur plotësisht e njëjtë, pa asnjë ndryshim në formulim;
- Nuk është shtuar asnjë kriter i ri që do të kërkonte në mënyrë eksplicite leje për trajtimin e azbestit;
- GOE ka dorëzuar të njëjtat lloje dëshmish, në përputhje me kërkesën e DT-së.

Megjithatë, përkundër vendimit paraprak të OSHP-së për të njëjtën çështje, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë identike dhe ka eliminuar sërish oferten tone me të njëjtin arsyetim, duke pretenduar se leja nuk është e destinuar për azbest.

Ky veprim i AK-së është i kundërligjshëm për arsyet në vijim

1. Injorim i drejtpërdrejtë i vendimit të OSHP-së - AK ka qenë në dijeni për vendimin e OSHP-së për këtë çështje, mirëpo ka zgjedhur ta injorojë atë dhe të aplikojë sërish të njëjtin interpretim të gabuar.

2. Ndryshim i kriterëve pas publikimit të tenderit - Duke kërkuar në praktikë një leje specifike për azbest, AK ka vendosur një kriter që nuk ekziston në DT, duke e ndryshuar kriterin në fazën e vlerësimit.

3. Shkelje e sigurisë juridike dhe konsistencës - Për të njëjtin kriter dhe të njëjtat dokumente:

- OSHP ka konstatuar përmbushje të kërkesës;
- ndërsa AK, pa ndryshuar asgjë në DT, arrin në përfundim të kundërt.

4. Shkelje e nenit 59 të LPP-së - Vlerësimi nuk është bërë mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në DT.

Në thelb, kemi një situatë ku:

- për të njëjtin kriter,
- me të njëjtin dokumentacion,
- dhe me një interpretim tashmë të dhënë nga OSHP,

Autoriteti Kontraktues vendos sërish të eliminojë GOE duke përdorur të njëjtin arsyetim, të cilin OSHP e ka konsideruar të pabazuar.

Ky veprim përbën jo vetëm shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik, por edhe **cenim serioz të parimit të sigurisë juridike dhe autoritetit të vendimeve të OSHP-së**, duke krijuar një situatë ku vendimet e këtij institucioni nuk respektohen në praktikë.

Eliminimi i GOE është i pabazuar dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kërkesat e vetë Dosjes së Tenderit; si dhe me vendimin paraprak të OSHP për të njëjtën çështje.

Bashkangjitur:

- Vendimi i OSHP nr. 2025/1118;
- Ekspertiza nr. 2025/1118, pretendimi 2.

Pretendimi 2

Gjatë fazës së vlerësimit, Autoriteti Kontraktues na është drejtuar me kërkesë për sqarim, duke u bazuar në nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenin 41.6 të Rregullores për Prokurim Publik, me arsyetimin se oferta jonë prej **21,760.00 EUR** është dukshëm më e ulët krahasuar me vlerën e parashikuar (**50,000.00 EUR**) dhe ofertat tjera të pranuar në këtë aktivitet.

Në këtë aktivitet janë dorëzuar këto oferta:

- GOE jonë: **21,760.00 EUR**
- Operator fitues: **37,600.00 EUR**
- Dy oferta tjera: **49,604.00 EUR** dhe **49,999.99 EUR**

Autoriteti Kontraktues ka konsideruar vetëm ofertën tonë si anomalisht të ulët, ndërsa ka shpallur fitues një operator ekonomik me çmim **37,600.00 EUR**, pa e trajtuar këtë ofertë si anomalisht të ulët, pavarësisht se:

- është dukshëm më e ulët se dy ofertat tjera prej rreth 49,000.00 EUR;
- dhe devijon ndjeshëm nga çmimi i tregut i shprehur përmes ofertave të tjera të pranuar.

Nëse oferta jonë prej **21,760.00 EUR** është konsideruar anomalisht e ulët për shkak të devijimit nga oferta fituese prej **37,600.00 EUR**, atëherë, sipas të njëjtës logjikë krahasuese dhe parimit të trajtimit të barabartë, edhe oferta e fituesit duhej të ishte trajtuar si potencialisht anomalisht e ulët, duke qenë se ekzistojnë dy oferta të tjera dukshëm më të larta (**49,604.00 EUR dhe 49,999.99 EUR**).

Ky trajtim selektiv tregon se Autoriteti Kontraktues:

- nuk ka aplikuar një metodologji të njëjtë dhe konsistente të vlerësimit për të gjitha ofertat;
- ka krahasuar në mënyrë të pjesshme vetëm ofertën tonë me ofertën fituese, duke injoruar strukturën e plotë të çmimeve të tregut;
- dhe ka krijuar standard të dyfishtë në vlerësimin e konceptit të “ofertës anomalisht të ulët”.

Në këtë kuadër, AK ka kërkuar sqarime lidhur me:

- formimin e çmimeve për të gjitha pozicionet;
- dëshmi për çmimet e përdorura;
- marzhën e fitimit;
- mënyrën e realizimit të kontratës;
- deklaratë shpjeguese për çmimin e ofertuar.

Në përgjigje, ne kemi dorëzuar sqarime të detajuara, duke u bazuar në nenin 61 të LPP-së, si vijon:

1. Oferta nuk është anomalisht e ulët

Oferta prej **21,760.00 EUR** është ndërtuar mbi parimin e efikasitetit operacional dhe optimizimit të kostove dhe nuk përbën ofertë të paqëndrueshme.

1.1 Struktura e kostos

- Fuqi punëtore e specializuar për materiale të rrezikshme dhe azbest;
- Pajisje mbrojtëse personale (PPE) sipas standardeve;
- Pajisje teknike dhe mjete pune;
- Transport i kontrolluar i mbetjeve të rrezikshme;
- Trajtim dhe deponim sipas kërkesave ligjore.

1.2 Faktorët që mundësojnë çmimin konkurrues

- Kapacitete ekzistuese teknike që reduktojnë kostot e mobilizimit;
- Staf i brendshëm i certifikuar pa nënkontraktim të kushtueshëm;
- Marrëveshje paraprake për transport;
- Optimizim i logjistikës dhe planifikimit.

1.3 Marzha e fitimit

Marzha e fitimit është e reduktuar duke marrë parasysh natyrën strategjike të projektit.

1.4 Qëndrueshmëria e ofertës

Ne kemi deklaruar se: oferta mbulon të gjitha kostot direkte dhe indirekte; nuk rrezikon cilësinë dhe sigurinë; është plotësisht e realizueshme.

Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se: sqarimet janë të përgjithshme dhe jo të mjaftueshme; mungojnë dëshmi konkrete si fatura, kontrata apo kalkulime të detajuara; nuk është dëshmuar realizueshmëria e projektit me çmimin e ofertuar; rrjedhimisht oferta është konsideruar si anomalisht e ulët dhe është refuzuar si e papranueshme.

Neni 61 nuk kërkon dorëzim të: faturave konkrete; kontratave komerciale; apo dokumenteve financiare të detajuara konfidenciale.

Ai kërkon vetëm **arsyetim të besueshëm dhe të arsyeshëm**, i cili është dhënë përmes: strukturës së kostos; kapaciteteve teknike; dhe organizimit operacional.

Sipas nenit 41.3, kërkesa për sqarim për ofertë anomalisht të ulët mund të bëhet vetëm nëse plotësohen **kumulativisht** këto kushte:

- I. çmimi është >30% më i ulët se mesatarja e tenderëve të përgjegjshëm;
- II. çmimi është >10% më i ulët se oferta e dytë më e ulët;
- III. janë të paktën 3 tenderë të përgjegjshëm.

Në rastin konkret:

- nuk plotësohet kushti për **3 tenderë të përgjegjshëm**, pasi vetëm 1 ofertë është konsideruar e përgjegjshme (fituesi).

Prandaj mekanizmi i nenit 41.3 është aplikuar në mënyrë të pasaktë; dhe kërkesa për sqarim është juridikisht e pambështetur.

Në këto rrethana AK ka aplikuar gabimisht nenin 41.3, ka vlerësuar ofertën tonë në mënyrë jo konsistente dhe selektive dhe ka krijuar standard të dyfishtë në trajtimin e ofertave.

Rrjedhimisht, eliminimi i GOE është i pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe proporcionalitetit.

Pretendimi 3

Gjatë fazës së vlerësimit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime lidhur me përmbushjen e kërkesës për kapacitet teknik dhe profesional, konkretisht Kërkesën nr. 5 të pikave 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit, e cila ka të bëjë me ekspertin për trajtimin e materialeve me përmbajtje azbesti. Sipas kësaj kërkesë, është kërkuar një (1) ekspert i certifikuar sipas normave ndërkombëtare, me dëshmi për kontroll, inventarizim, largim dhe menaxhim të azbestit, si dhe me njohuri teknike për sigurinë dhe shëndetin në zonat e kontaminuara, përfshirë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse dhe trajtimin e pluhurit të fibrave të azbestit.

Në ofertën tonë është dorëzuar kontratë me ekspertin e propozuar z. Vilaznim Mula. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se kontrata është nënshkruar nga z. Zeqir Hasani, dhe për këtë arsye ka kërkuar sqarim lidhur me këtë mospërputhje, si dhe ka kërkuar një deklaratë nën betim nga eksperti i propozuar, me qëllim konfirmimin e marrëveshjes së angazhimit.

Në përgjigje të kësaj kërkesë ne kemi sqaruar se nënshkrimi i kontratës nga z. Zeqir Hasani ka qenë rezultat i një gabimi teknik dhe administrativ gjatë përgatitjes së dokumentacionit, i cili nuk ndikon në vlefshmërinë substanciale të marrëveshjes me ekspertin dhe nuk cenon ekzistencën e saj. Në këtë kuptim, marrëdhënia kontraktuale me ekspertin ekziston dhe është e vlefshme, ndërsa gabimi i nënshkrimit është thjesht formal.

Gjithashtu, sipas kërkesës së Komunes kemi dorëzuar deklaratë nën betim të nënshkruar nga z. Vllaznim Mula, përmes së cilës ai konfirmon qartë angazhimin e tij në projekt dhe pranimin e parakontratës, duke vërtetuar vullnetin dhe gatishmërinë për realizimin e detyrave të parapara në Dosjen e Tenderit. Për më tepër, është dëshmuar se eksperti posedon certifikimet dhe përvojën e kërkuar, përfshirë kontrollin dhe inventarizimin e azbestit, largimin dhe menaxhimin e tij, njohuritë për sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe përvojë të mëparshme në projekte relevante në këtë fushë.

Pavarësisht këtyre sqarimeve dhe dokumenteve mbështetëse, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se ekziston mospërputhje në nënshkrimin e parakontratës dhe ka vlerësuar se nuk është dhënë sqarim i mjaftueshëm dhe i verifikueshëm për ekzistencën e një marrëdhënieje të rregullt kontraktuale para dorëzimit të ofertës, duke eliminuar GOE nga procedura.

Një qasje e tillë është e pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me parimet e vlerësimit substancial të ofertave, pasi nënshkrimi i gabuar i kontratës përbën një gabim thjesht formal dhe administrativ, i cili nuk ndikon në përmbajtjen, vlefshmërinë dhe ekzistencën reale të marrëveshjes me ekspertin. Dokumentet e dorëzuara, përfshirë deklaratën nën betim, konfirmojnë në mënyrë të qartë angazhimin e ekspertit dhe përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Për më tepër, eliminimi i GOE në këtë rast është në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, pasi një gabim teknik i natyrës formale është trajtuar si mungesë substanciale e kapacitetit profesional, pa ndonjë ndikim real në aftësinë e ofertuesit për të realizuar kontratën. Po ashtu, ky vlerësim nuk është bërë në mënyrë objektive dhe të plotë, duke mos marrë parasysh në mënyrë adekuate sqarimet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga ne pas kërkesës për sqarime. Rrjedhimisht, konstatohet se eliminimi i ofrës sone për këtë arsye është i pabazuar dhe në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit, si dhe me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimi 4

Në procedurën e parë të këtij aktiviteti të prokurimit, Grupi i Operatorëve Ekonomik **EGO ELSA SH.P.K.; PRINCI COMPANY SH.P.K.; Hom and Co. Analytics SH.P.K.** është eliminuar me arsyetimin: *Nuk është dëshmuar pëlqimi mjedisor për grumbullimin, ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënojave, i destinuar për azbest, sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe Aneksit 1. Prandaj, kjo ofertë është e papërgjegjshme.*

Ndërsa në këtë procedurë të ri-tenderuar, i njëjti kriter është përdorur për eliminimin e ofertës sonë, **por jo për operatorin ekonomik të shpallur fitues, përkundër faktit se:**

- Operatori ekonomik i shpallur fitues ka ofertuar me çmim **37,600 €**,
- Ndërsa oferta jonë është **21,760 €**, pra dukshëm më e ulët dhe ekonomikisht më e favorshme.

Pas pranimit të vendimit, ne kemi parashtruar kërkesë për qasje në dokumentacion në përputhje me nenin 10 të LPP-së, me datë 23.04.2026. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar qasje deri më datë 27.04.2026, që përkon me afatin e fundit për parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim, duke kufizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën tonë për mjete juridike efektive.

Autoriteti Kontraktues, përkatësisht Komuna e Prishtinës, ka refuzuar të na japë qasje në dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues. Si rrjedhojë e këtij veprimi:

- Ne nuk kemi pasur mundësi të verifikojmë nëse operatori fitues **posedon apo jo pëlqimin mjedisor** të kërkuar;
- Duke pasur parasysh trajtimin në procedurën e parë dhe eliminimin tonë për të njëjtën çështje, krijohet një **dyshim i arsyeshëm se operatori fitues nuk e plotëson këtë kërkesë**, por megjithatë është shpallur fitues.

Veprimi i Autoritetit Kontraktues për të mos lejuar qasje përbën shkelje të nenit 10 të LPP-së.

Ky veprim i AK-së çon në:

1. **Mungesë transparence në procedurë** - Duke mos lejuar qasje në dokumente kyçe të vlerësimit, pengohet e drejta jonë për mbrojtje efektive.
2. **Trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë**
 - o Ne jemi eliminuar për një kriter të caktuar;
 - o Ndërsa operatori fitues, për të njëjtin kriter, nuk i nënshtrohet të njëjtit standard verifikimi.
3. **Dyshim të arsyeshëm për vlerësim jo objektiv** - Refuzimi i qasjes në dokumente që janë thelbësore për verifikim krijon perceptim të fortë se:
 - o ose dokumenti nuk ekziston,
 - o ose nuk i përmbush kërkesat e DT-së.
4. **Shkelje të nenit 10 të LPP-së**
 - o Neni 10 garanton qasje në dokumente.

Pretendimi 5

Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim për refuzimin e ofertës sonë, ndonëse e njëjta është e plotë, e përgjegjshme dhe në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Ky vendim bie në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, të përcaktuara në nenet 1, 6, 7 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Së pari, në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së, i cili përcakton se qëllimi i ligjit është sigurimi i një procesi transparent, jodiskriminues dhe që garanton vlerën më të mirë për parandë publike, Autoriteti Kontraktues ka eliminuar një ofertë të përgjegjshme pa bazë të qëndrueshme ligjore, duke cenuar kështu vetë qëllimin e ligjit.

Së dyti, në kundërshtim me nenin 6 të LPP-së, i cili obligon autoritetet kontraktuese të sigurojnë përdorim ekonomik, efikas dhe efektiv të fondeve publike, refuzimi i ofertës sonë – e cila është ekonomikisht më e favorshme – përbën veprim që dëmton interesin publik dhe pengon arritjen e efikasitetit në këtë procedurë.

Së treti, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, që garanton trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar

Parashtruesi po ashtu ka parashtruar pretendime ankimore sipas të cilave oferta e tenderuesit te rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme për arsyet e prezantuara në kërkesën për rishqyrtim.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina

SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT
KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2 - PRISHTINË

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar1

Titulli i kontratës: Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet-Ritender

Nr. i Prokurimit: 616-26-40-5-2-1

Të nderuar (a)

Operatorë Ekonomik: GOE: ASSET ING SH.P.K.; EKO-TEAM; LEDI SH.P.K.

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

[Tenderi i juaj] është i papërgjegjshëm

Nuk i keni përmbushur kërkesat e DT-së dhe Njoftimit për Kontratë: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

ARSYETIM: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju si OE-ik me oferte financiare me çmim prej: **21,760.00 EUR**, Komisioni pas shqyrtimit, analizimit dhe krahasimit të ofertës me kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, konstaton se ky operator nuk është i përgjegjshëm, pasi me ofertën e tij dhe me sqarimet e kërkuara shtese te datës 24.03.2026 përmes letër standarde Eprokurimi te pranuar me datën 28.03.2026 përmes Eprokurimi nuk ka dëshmuar se i plotëson kriteret e dhenjes se kontrates sipas doosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate:

- 1 GOE me ofertën e tyre nuk kanë arritur të dëshmojnë kërkesën: **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional pika 2 e DT-së: dhe Aneksit 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME** pasi që GOE me ofertën leja mjedisore e paraqitur nuk është e destinuar për Azbest.
2. GOE lidhur me ofertën e tij nuk ka ofruar sqarime bindëse, pavarësisht kërkesës së autoritetit kontraktues për sqarime shtesë lidhur me ofertën abnormalisht të ulët.

Vlera e parashikuar për këtë aktivitet është 50,000.00 EUR, ndërsa oferta e dorëzuar nga operatori ekonomik është 21,760.00 EUR. Krahasuar me ofertat tjera të pranuar në këtë aktivitet, të cilat janë

Faqe 9 nga 11

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

37,600.00 EUR, 49,604.00 EUR dhe 49,999.99 EUR, oferta në fjalë rezulton dukshëm më e ulët dhe konsiderohet ofertë anomalisht e ulët.

Pas shqyrtimit të sqarimeve të dorëzuara, konstatohet se ato janë të përgjithshme dhe nuk përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm dhe të verifikueshëm për çmimin e ofertuar. Operatori ekonomik ka paraqitur vetëm deklarime të përgjithshme, kapacitetet ekzistuese dhe optimizimin e shpenzimeve, pa ofruar analiza të detajuara financiare, fatura, kontrata të ngjashme apo kalkulime të qarta të kostos për secilin pozicion.

Gjithashtu, nuk është paraqitur një ndarje e argumentuar e kostove që do të dëshmonte realizueshmërinë e projektit me çmimin e ofertuar, si dhe mungon specifikimi i saktë i marzhës së fitimit. Për më tepër, operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë në mënyrë të besueshme se oferta e tij garanton zbatimin e plotë, cilësor dhe të qëndrueshëm të kontratës.

Duke qenë se edhe pas kërkesës për sqarime shtesë nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe bindëse për të arsyetuar nivelin e ulët të çmimit, autoriteti kontraktues vlerëson se oferta nuk është e përgjegjshme dhe nuk dëshmon aftësinë për realizimin e projektit me çmimin e ofertuar.

Rrjedhimisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe trajtimin e ofertave anomalisht të ulëta, kjo ofertë refuzohet si e papranueshme.

3. Lidhur me parakontratën e dorëzuar për ekspertin e propozuar, konstatohet mospërputhje në nënshkrim, pasi dokumenti është i nënshkruar nga z. Zeqir Hasani, ndërsa si ekspert është deklaruar z. Vllaznim Mula. Pavarësisht kërkesës për sqarime, operatori ekonomik ka deklaruar se bëhet fjalë për gabim teknik dhe ka dorëzuar deklaratë nën betim nga z. Vllaznim Mula. Megjithatë, nuk është dhënë sqarim i mjaftueshëm dhe i verifikueshëm për nënshkrimin fillestar dhe për ekzistencën e një marrëdhënieje të rregullt kontraktuale para dorëzimit të ofertës.

Në mungesë të sqarimeve bindëse dhe dëshmime të mjaftueshme, autoriteti kontraktues vlerëson se dokumentacioni nuk është i besueshëm dhe nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt:
Sektori i Prokurimit

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme, me përjashtim të pretendimit për pjesën e licensës i cili pretendim është gjetur si i bazuar. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Në fakt edhe vet parashtruesi nuk i kundërshton drejtpërdrejtë këto arsye eliminuese por eventualisht thotë që ato përbëjnë devijime materiale (të vogla) për të cilat nuk është dashur të eliminohet ose thotë që AK është dashur t'i kërkoj sqarime shtesë për ti dhënë mundësinë që ti përmisoj gabimet e bëra në oferta.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij përpos pretendimit për licensë. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është miratuar pjesërisht por vetëm sa i përket pretendimit për licensë ndërsa pretendimet tjera të gjitha janë refuzuar si të pabazuara.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.05.20256



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.